

SHËNOHET 25-VJETORI I MASAKRËS SË REÇAKUT

KOSOVA NUK DO TA HARROJË KURRË MASAKRËN E REÇAKUT



Të hënën është shënuar 25-vjetori i masakrës së Reçakut, një nga ngjarjet më të dhimbshme që përjetoj populli ynë. Aty u vranë mizorisht 45 shqiptarë, fëmijë, gra dhe burra. Krerët e institucioneve shtetërore, presidentja Osmani, kryeministri Kurti, kryeparlamentari Konjufca, kabineti qeveritar dhe liderët e opozitës, ditën e 15 janarit e nisën me homazhe dhe akademi përkujtimore në nderim të të rënëve në masakrën e Reçakut. Ata bënë thirrje që autorët e këtij krimi të dalin para drejtësisë, ndërsa siguruan që kjo ngjarje nuk do të harrohet kurrë

NDIZEN QIRINJ PËR VIKTIMAT E GJENOCIDIT NË KOSOVË: 15 JANARI TË NGULITET NË VETËDIJEN E ÇDO QYTETARI SHQIPTAR



F. 5

SESIONI PRANVEROR I KUVENDIT NIS TË ENJTEN ME DEBATIN PËR ÇMIMIN E RRYMËS



F. 3

OPINION

GRUPI REVOLUCIONAR I TIRANËS GARANTON FITOREN E ALI AHMETIT F. 7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE

**OKB-ja BËN THIRRJE PËR 4.2 MILIARDË DOLLARË NDIHMË HUMANITARE PËR UKRAINËN** F. 2

KPK-ja SHPALL KONKURS PËR 28 PROKURORË TË RINJ F. 3

EKONOMI

**BIZNESET, TË PAKËNAQURA ME NDRYSHIMET LIGJORE PËR KONTRATA TË PUNËTORËVE** F. 8

SPORT

**DAVISI, MVP I DERBIT DHE JAVËS; JOHNSONI, MVP NË SUPERLIGËN E FEMRAVE** F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

OKB-ja bën thirrje për 4.2 miliardë dollarë ndihmë humanitare për Ukrainën

NJU-JORK, 15 JANAR - Kombet e Bashkuara u kanë kërkuar donatorëve që gjatë këtij viti të japin 4.2 miliardë dollarë ndihmë humanitare për ukrainasit në shtetin e shkatërruar nga lufta dhe për ata që janë larguar nga shteti, përdërisa pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës po i afrohet përvjetorit të dytë. Mbi 14.6 milionë ukrainas brenda vendit, apo 40 për qind e popullsisë së përgjithshme, kanë nevojë për ndihmë humanitare gjatë këtij viti, tha zyra për Koordinim të Çështjeve Humanitare (OCHA). Lufta, po ashtu, ka detyruar rreth 6.3 milionë ukrainas që të gjejnë strehim jashtë vendit, ndërkaq në fund të vitit 2023, 5.9 milionë refugjatë ishin strehuar në Evropë, njoftoi OCHA. “Qindra mijëra fëmijë jetojnë në komunitetet në frontet e luftës, të tmerruar, traumatizuar dhe pa

nevojat elementare. Vetëm ky fakt na bën që të bëjmë gjithçka që të dërgojmë më shumë ndihmë humanitare për Ukrainën”, tha shefi i OCHA-s, Martin Griffiths. Që nga nisja e këtij viti, Ukraina po përballlet me një fushatë intensive të sulmeve ajrore ruse, duke vështirësuar edhe më shumë jetën e civilëve. “Në rajonet e Donjeckut dhe Harkivit strehimoret në shtëpitë e dëmtuara nuk kanë furnizim me ujë, gaz e as rrymë. Bombardimet e vazhdueshme po i detyrojnë banorët t’i kalojnë ditët e tyre në bodrume”, tha ai. Agjencia për ndihmë e OKB-së tha se 3.1 miliardë dollarë, apo 75 për qind e shumës së përgjithshme, do të dërgohen për të ndihmuar 8.5 milionë persona brenda Ukrainës, ndërkaq 1.1 miliard për t’i ndihmuar refugjatët në shtetet ku janë strehuar.



Koreja e Veriut teston një raketë hipersonike

PENIAN, 15 JANAR - Koreja e Veriut tha se ka testuar një raketë të re me rreze të mesme veprimi, që operon me lëndë djegëse të ngurta, e pajisur me një kokë bërthamore hipersonike, përdërisa Peniani po synon të dizajnojë armë më të fuqishme që mund të godasin caqet e largëta amerikane në rajon. Njoftimi i 15 janarit nga media shtetërore e Koresë së Veriut vjen një ditë pasi ushtritë e Koresë së Jugut dhe të Japonisë detektuan lëshimin e një rakete nga një zonë afër kryeqytetit verikorean, Penian. Ky ishte testimi i parë balistik i Veriut më 2024. Lëshimi i raketës vjen dy muaj pasi Koreja e Veriut tha se me sukses ka testuar motorët e një rakete balistike me rreze të mesme



veprimi që operon me lëndë djegëse të ngurta. Ky njoftim paraqet një avancim të armëve verikorean që mund t’i

shënjestrojë bazat ushtarake amerikane në Guam dhe Japoni. Agjencia Qendrore e Lajmeve e Koresë së Veriut (KCNA) tha se

testimi i së dielës synonte ta verifikonte besueshmërinë e motorëve me lëndë të ngurta dhe aftësitë manovruese të kokës hipersonike. KCNA tha se testimi u krye me sukses, por nuk dha më shumë hollësi. Ushtria e Koresë së Jugut tha se raketa fluturoi rreth 1 000 kilometra para se të binte në ujërat në mes të Gadishullit Korean dhe Japonisë. Raketat ekzistuese balistike të Veriut me rreze të mesme veprimi përfshijnë edhe raketën Hwasong-12 dhe ato mund të jenë në gjendje ta arrijnë qendrën e ushtrisë amerikane në Guam në Paqësor. Raketat që ndërtohen me shtytës që funksionojnë me lëndë të ngurta mund të lëshohen më shpejt dhe lëvizin më lehtë dhe

teknikisht ua bëjnë më të vështirë armiqve t’i detektojnë ato. Që nga viti 2021 Koreja e Veriut ka testuar koka hipersonike, që janë pesë herë më të shpejta sesa shpejtësia e zërit. Nëse Veriu perfeksionon këto armë, sisteme të tilla potencialisht mund të paraqesin sfidë për sistemet mbrojtëse kundërraketore në rajon për shkak se këto lloje armësh kanë shpejtësi të madhe dhe janë të afta të manovrojnë. Tensionet në Gadishullin Korean janë në nivelin më të lartë në vitet e fundit pasi lideri verikorean Kim Jong Un shtoi demonstrimin e armëve. ShBA-ja dhe aleatët u janë kundërpërgjigjur testeve verikoreane me forcimin e stërvitjeve të tyre të përbashkëta ushtarake.

FMN-ja: Inteligjenca artificiale do të ‘godasë’ 40 % të vendeve të punës dhe do ta përkeqësojë pabarazinë

NJU-JORK, 15 JANAR - Inteligjenca artificiale do të prekë gati 40 % të të gjitha vendeve të punës, sipas një analize të re nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Kristalina Georgieva, thotë se “AI do ta përkeqësojë pabarazinë”, raporton BBC. Georgieva shtoi se politikëbërësit duhet ta adresojnë “prijeten shqetësuese” për ta “parandaluar teknologjinë nga nxitja e mëtejshme e tensioneve sociale”. Përhapja e inteligjencës artificiale ka vënë në qendër të vëmendjes përfitimet dhe rreziqet e saj. FMN

tha se AI ka të ngjarë të ndikojë në një përqindje më të madhe të vendeve të punës, në rreth 60 % në ekonomitë e përparuara. Në gjysmën e këtyre rasteve punëtorët mund të presin të përfitojnë nga integrimi i AI, i cili do ta rrisë produktivitetin e tyre. Në raste të tjera, AI do ta ketë aftësinë të kryejë detyra kyçe që aktualisht bëhen nga njerëzit. Kjo mund ta ulë kërkesën për punë, duke ndikuar në pagat dhe duke zhdukur vendet e punës. Ndërkohë, FMN-ja projektonte se teknologjia do të prekë vetëm 26 % të vendeve të punës në vendet me

të ardhura të ulëta. Georgieva tha se “shumë nga këto vende nuk kanë infrastrukturë ose fuqi punëtore të aftë për t’i shfrytëzuar përfitimet e AI-së, duke rritur rrezikun që me kalimin e kohës teknologjia mund ta përkeqësojë pabarazinë midis kombeve”. Në përgjithësi, punëtorët me të ardhura më të larta dhe ata më të rinj mund të shohin një rritje disproporcionale në pagat e tyre pas adoptimit të AI-së. Punëtorët me të ardhura më të ulëta dhe ata më të vjetër mund të mbeten prapa, sipas FMN-së.



KPK-ja shpall konkurs për 28 prokurorë të rinj

PRISHTINË, 15 JANAR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka shpallur konkurs për 28 pozita për prokurorë të rinj. Shpallja e konkursit është bërë pasi është paraqitur analiza nga zëvendëskryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, i cili ka propozuar që konkursi të shpallet për 28 pozita,

raporton “Betimi për Drejtësi”. Ndërsa kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, ka thënë se konkursi do të shpallet më 22 janar 2024. Komisioni për Rekrutim do të jetë i përbërë nga: Ardian Hajdari, Jehona Grantolli, Armend Zenelaj, Aleksandër

Lumezi, Blerim Isufaj, dhe anëtarë rezervë Ariana Shajkovci dhe Idain Smajli, në krye me Aleksandër Lumezin. Në Komisionin për Rishqyrtim janë caktuar: Arian Gashi, Bahri Hyseni dhe Bedrije Sylja-Alshiqi, kurse anëtarë rezervë Merita Bina-Rugova dhe Arben Ismajli.



Viola von Cramon kërkon përparim në dialog para zgjedhjeve në BE



Faton DËRMAKU
PRISHTINË, 15 JANAR - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, i bëri thirrje udhëheqjes në Kosovë që të bëjë përparim në dialogun me Serbinë, përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe para se blloku evropian të mbajë zgjedhje më 9 qershor. Në një konference për medie në Prishtinë të hënën pas një vizite disaditore në Kosovë, von Cramon u shpreh e brengosur për mbështetjen që mund të ketë Kosova në PE pas zgjedhjeve të qershorit. Ajo tha se sondazhet kanë treguar për një rritje në Evropë të partive të djathta,

veçmas të ekstremit të djathtë. “Mendoj se një përbërje e re e Parlamentit Evropian mund të ketë efekt në raport me Kosovën dhe shtetet e tjera të cilat potencialisht mund të jenë shtete kandidatë për anëtarësim në BE”, ka theksuar Cramon. Sipas von Cramon, në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga BE-ja, ka pasur përparim. Por, ajo tha se vitin e kaluar është bërë “një gabim i madh”, pasi palëve nuk u është kërkuar ta nënshkruajnë marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit, as Aneksin për zbatimin e saj. Pavarësisht prej trysisë ndërkombëtare që palët ta zbatojnë marrëveshjen, blloku evropian ka thënë se ajo nuk po

zbatohet. Marrëveshja për normalizim, prej 11 nenesesh, ndër të tjera, parashihet edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Marrëveshja Bazë e arritur në shkurt të vitit të kaluar në Bruksel, më pas Aneksi për zbatimin e saj që u arrit në mars në Ohër, nuk u nënshkruan. Por, BE-ja ka thënë se marrëveshja është ligjërish e obligueshme për palët. “Mendoj se vitin e kaluar është bërë një gabim për Marrëveshjen e Ohrit, duke mos insistuar në nënshkrimin e Marrëveshjes

[Bazë] dhe Aneksit [të zbatimi] nga të dyja anët. Mendoj se ky ka qenë një gabim i madh. Mendoj se nëse e vonojmë procesin mund të kemi probleme, sepse i kemi zgjedhjet në BE në verë dhe pastaj mund të vijmë në fuqi disa individë që nuk e përkrahin shumë Kosovën. Pastaj ne kemi Gazën, Ukrainën, Tajvanin, gjëra të ndryshme, probleme të ndryshme dhe jam e brengosur që në fund të ditës askush nuk brengoset për dialogun”, ka deklaruar von Cramon. Eurodeputetja tha se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është një kërkesë legjitime, duke shtuar se Kosova duhet të dalë me një propozim për formimin e tij dhe ta ratifikojë marrëveshjen për këtë gjë.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013, më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t’i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. Në tetor të vitit 2023 përfaqësuesit e BE-së, të ShBA-së, të Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë ua paraqitën palëve, Kosovës dhe Serbisë, draft-statutinin për formimin e Asociacionit, të cilin kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb, Aleksandar Vučić, e pranuan në parim.

Sesioni pranveror i Kuvendit nis të enjten me debatin për çmimin e rrymës

PRISHTINË, 15 JANAR - Sesioni pranveror në Kuvendin e Kosovës do të nisë me një seancë të jashtëzakonshme të enjten. Temë e diskutimit do të jetë çmimi i energjisë elektrike, ka bërë me dije të hënën shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, i cili ka thënë se aktualisht në vendin tonë nuk

ka temë më të rëndësishme. “Ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, me mbështetjen e 40 deputetëve nga radhët e partive parlamentare opozitare kemi thirrur një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për çështjen e energjisë elektrike në vendin tonë. Nuk ka asnjë temë më të

rëndësishme sesa që sesioni i parë të fillojë për çmimin e energjisë elektrike”, ka deklaruar Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. Ai ka thënë se kanë propozuar edhe një rezolutë me të cilën kërkohet ulja e çmimit të energjisë elektrike dhe heqja e bllok-tarifave.





SHËNOHET 25-VJETORI I MASAKRËS SË REÇAKUT

Kosova nuk do ta harrojë kurrë masakrën e Reçakut

Të hënën është shënuar 25-vjetori i masakrës së Reçakut, një nga ngjarjet më të dhimbshme që përjetoj populli ynë. Aty u vranë mizorisht 45 shqiptarë, fëmijë, gra dhe burra. Krerët e institucioneve shtetërore, presidentja Osmani, kryeministri Kurti, kryeparlamentari Konjufca, kabineti qeveritar dhe liderët e opozitës, ditën e 15 janarit e nisën me homazhe dhe akademi përkujtimore në nderim të të rënëve në masakrën e Reçakut. Ata bënë thirrje që autorët e këtij krimi të dalin para drejtësisë, ndërsa siguruan që kjo ngjarje nuk do të harrohet kurrë

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

REÇAK, 15 JANAR - Në Kosovë më 15 janar krerët shtetërorë nderuan viktimat e masakrës së Reçakut. Në këtë fshat të Shtimes, 25 vjet më parë forcat serbe vranë 45 civilë shqiptarë. Gjatë vendosjes së kurorave me lule në këtë fshat të Shtimes, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, falënderoi ish-ambasadorin amerikan William Walker, i cili ishte i pranishëm në këtë ceremoni.

Walker gjatë vitit 1999 kishte shërbyer shëf i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe kishte dokumentar krimet e kryera në këtë fshat.

Sipas Osmanit, masakra e Reçakut ndërkombëtarizoi

çështjen e Kosovës. Ajo tha se Walkeri për 25 vjet ka punuar që të mbrojë të vërtetën e Reçakut, por shtoi se kjo ngjarje ende mohohet në Serbi. "... në një kohë kur, për fat të keq, regjimi i sotëm i [presidentit serb, Aleksandar] Vuçiqit, që është vazhdimësi e regjimit të [ish-udhëheqësit serb, Slobodan] Millosheviqit, jo vetëm që mohon masakrën e Reçakut, por edhe i arreston e torturon ata të cilët vendosin lule mbi varret e fëmijëve të vrarë gjatë luftës", tha Osmani.

Për Walkerin ky përvjetor është ngjarje emocionuese, por ai shtoi se banorët e këtij fshati sakrifkuan që qytetarët ta kenë sot Republikën e Kosovës. "Kam ardhur sot, siç kam ardhur në 25 vjetët e fundit, për të parë se çfarë ka mbetur nga ajo kujtesë në mesin e të rinjve, që janë nën



25 vjeç, e nën 30 vjeç, që mendoj se përbëjnë 30 për qind të popullsisë. Këta të rinj nuk kanë kujtesë të veten se si ishte jeta në Kosovë nën diktatin e Millosheviqit dhe Qeverisë në

Beograd. Për mua Reçaku përfaqëson një ndryshim, një lëvizje nga ajo se çfarë Reçaku përfaqëson sot. Për mua përfaqëson atë që Kosova ka arritur të bëjë që nga viti 2008",

tha Walkeri gjatë ceremonisë përkujtimore.

Gjatë akademisë përkujtimore për 25-vjetorin e ngjarjeve në Reçak, Osmani tha se masakra e ndodhur në këtë fshat të

Shtimes “tronditi themelet e ndërgjegjes njerëzore kudo në botën demokratike”. “Sepse bota përjetoj një ndër masakrat më të tmerrshme që ka ndodhur në Evropë në fund të shekullit 20. Kjo masakër ka dëshmitarë të gjallë të cilët përjetuan llahtarinë e asaj dite. Përveç banorëve të mbijetuar, dëshmitë e të cilëve janë thelbësore, jo vetëm për kujtesën tonë historike, por edhe për zbardhjen e autorit të krimit, kjo masakër pati edhe një krye-dëshmitar i cili ndodhet me ne edhe në këtë përvjetor, ambasadorin William Walker”, tha Osmani, duke shtuar se dëshmia e ish-ambasadorit ishte kthesë në përpjekjet e Kosovës për liri. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se masakra e Reçakut ishte ngjarjeje tronditëse e para 25 viteve, dhimbja e së cilës vijon dhe kërkon drejtësi. Ai ka thënë se masakra e Reçakut ishte një nga aktet më mizore dhe dëshmia që u dha jehonë botërore krimeve të luftës dhe gjenocidit të Serbisë ndaj popullit shqiptar në Kosovë. “Ashtu siç, në anën tjetër, përmes pamjeve të këtij krimi të përbindshëm bota perëndimore u gjend përballë faktit të një populli të vendosur për lirinë e vet me çdo kusht, deri në sakrificat më të epërme. Vetëm unifikimi i demokracive si pasojë e Reçakut për të vendosur më pas vijat e kuqe solli bombardimet e NATO-s, që i hapën rrugën çlirimit të plotë të Kosovës. Është detyra jonë që gjithmonë t’i kujtojmë martirët e Reçakut, ashtu edhe dëshmorët që ranë në përpjekje për ta mbrojtur popullatën civile të Reçakut, në të njëjtën kohë të kërkojmë drejtësi për ta, të mos ndalojmë së kërkuari dënimin e kriminelëve të forcave militare dhe paramilitare të Serbisë gjenocidale”, ka deklaruar Konjufca, duke shtuar se ata martirë janë në themelin e shtetit tonë. “Martirizimi i tyre është plaga jonë që kujtesën e

bën premtim dhe qëllim të padiskutueshëm të drejtësisë dhe dinjitetit për këdo”, është shprehur ai. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se më 15 janar, në një dimër jashtëzakonisht të ftohtë, patë ndodhur ky krim makabër. Po sipas tij, varrimi i 45 civilëve ka ndodhur vetëm katër javë më vonë sepse ka pasur luftë të madhe për kufomat. Ai shtoi se janë edhe 11 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kanë rënë në betejë për mbrojtjen e trupave të masakruar nga Serbia dhe se ato katër javë tregojnë që Serbia është përpjekur ta deformojë të vërtetën e ta justifikojë krimin. Në fund, duke falënderuar ambasadorin Walker, kryeministri Kurti theksoi se në një çast vendimtar e historik për popullin tonë, ambasadori Walker foli të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, atë që Serbia është përpjekur ta deformojë. “Kur ndodhi masakra e Reçakut, ambasadori William Walker, udhëheqës i OSBE-së në Kosovë, erdhi këtu te fshatarët dhe e foli të vërtetën. Tha kjo është masakër dhe është krim kundër njerëzimit. E dihet që e vërteta është armiku më i madh i diktatorëve dhe i shovinistëve, andaj edhe sot e kësaj dite ambasadori William Walker vazhdon të jetë ndërkombëtar i sulmuar dhe më i urreyer në Serbi ku vazhdon të dominojë një regjim autoritar, me ç’rast ish-ministri i Informatave të asaj kohe sot është president i Serbisë”, ka deklaruar Kurti. Në përvjetorin e masakrës së Reçakut, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, citoi thënien e dr. Martin Luther Kingut: “Padrejtësia kudo është kërcënim për drejtësinë diku tjetër”, duke bërë thirrje që të mos lejohet të mohohet ajo çfarë ndodhi në këtë fshat. “Mos lejoni që askush të mos e harrojë apo ta mohojë atë çfarë ndodhi në Reçak, ose pse Shtetet e Bashkuara dhe aleatët i dolën në mbrojtje popullit të Kosovës. Më kujtohet ajo ditë shumë mirë”, ka shkruar ai në

Ndizen qirinj për viktimat e gjenocidit në Kosovë: 15 janari të ngulitet në vetëdijen e çdo qytetari shqiptar

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISTINË, 15 JANAR - Me rastin e Ditës së Përkujtimit të Gjenocidit në Kosovë, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka ndezur të hënën qirinj në shkallët e Teatrit Kombëtar në Prishtinë, në shenjë përkujtimi për viktimat e gjenocidit në Kosovë. Ndezja e qirinje nën moton “Ne nuk harrojmë - Ndize një qiri për viktimat e gjenocidit në Kosovë”, është bërë edhe në sheshet e qyteteve tjera të vendit. Udhëheqësi i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Bardhyl Mahmuti, ka theksuar se 15 janari- Dita e Gjenocidit, duhet të ngulitet në vetëdijen e çdo qytetari shqiptar. Sipas tij, çështja e gjenocidit nuk u takon vetëm shqiptarëve, kjo i përket mbarë njerëzimit. Në këtë drejtim, ai ka thënë se Dita e Gjenocidit në Kosovë duhet të sensibilizohet në përmasa ndërkombëtare që drejtësia të

ngadhënej. “15 janari duhet të ngulitet në vetëdijen e çdo qytetari shqiptar, që ta shpërndajë në botë, sepse është dita e gjenocidit ndaj shqiptarëve. Çështja e gjenocidit nuk u takon vetëm shqiptarëve, kjo i përket mbarë njerëzimit dhe, në qoftë se arrijmë që ta sensibilizojmë çështjen e gjenocidit në përmasa ndërkombëtare atëherë do të kemi solidarizimin ndërkombëtar që drejtësia të ngadhënej dhe njëherë e përgjithmonë të kthejmë faqen e historisë”, ka thënë Bardhyl Mahmuti. Zëvendësudhëheqësi i kësaj qendre, Adnan Asllani, duke përmendur numrin e viktimave të luftës së fundit, ka kërkuar të dënohet gjenocidi serb që ka ndodhur 25 vjet më parë në Kosovë. “25 vjet më parë forcat serbe kanë kryer akte të tmerrshme gjenocidi duke vrarë mbi 10 mijë shqiptarë, duke përdhunuar mbi 25 mijë femra e meshkuj shqiptarë, duke dëbuar shumicën e popullit nga

Kosova dhe duke shkatërruar objektet e trashëgimisë kulturore shqiptare”, ka thënë ai. Përfaqësuesit e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” kanë theksuar se përkujtimi i viktimave të Gjenocidit në Kosovë është më e pakta që ata duhet të bëjnë në rrugëtimin për ngadhënjimin e drejtësisë dhe ndëshkimin e krimit. Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës, veprimtarja, Flora Brovina, ka kërkuar nga shtetet mike të Kosovës të nxjerrin rezoluta kundër gjenocidit, në mënyrë që Kosova të ketë më të lehtë ngritjen e akuzës ndaj Serbisë. “Institucionet qeveritare duhet që të punojnë më shumë që parlamentet e shteteve mike që na kanë pranuar si të pavarur, të nisin e të nxjerrin rezoluta kundër gjenocidit që ka ndodhur në Kosovë, pra secili shtet, duke filluar prej Shqipërisë, në mënyrë që të na lehtësohet puna për ngritjen e akuzës”, ka thënë Brovina.



platformën “X”. Homazhe në kompleksin memorial, në Reçak, në nderim të viktimave civile të masakruara nga forcat serbe, bënë edhe liderët e opozitës. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Kosova nuk do të heshtë asnjëherë për krimet ndaj popullatës civile shqiptare gjatë luftës së viteve 1998/99 derisa drejtësia të vihet në vend për secilën viktimitë të vendit tonë. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka theksuar se sot, teksa po largohemi një çerek shekulli nga kjo ngjarje e errët e historisë njerëzore, ndiejmë gjithë afërsinë me dhimbjet e asaj dite të familjarëve e të mbijetuarve. Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, tha se para 25 vjetësh një akt ç’njerëzor tronditi mbarë botën

demokratike dhe shtyri Perëndimin të mobilizohej dhe të ndalojë me forcë shfarosjen e një populli të tërë. Pas masakrës së Reçakut, në mars të vitit 1999, NATO sulmoi caqet ushtarake policore në ish-Jugosllavi. Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet janë ndërprerë më 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë kishte mundësuar edhe kthimin në shtëpitë e më shumë se 800 000 refugjatëve, personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Grupi revolucionar i Tiranës garanton fitoren e Ali Ahmetit



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Javelinët amerikanë dhe p..ët dimalbashiane: Opinioni që po kërkon luftë në Kosovë e që kurrë nuk e ka shkrepur asnjë plumb, personalisht dhe familjarisht për Kosovën dhe shqiptarët, po rrahagjoks se falë kësaj qeverie dhe KM Kurti, amerikanët po i shesin Kosovës antitank “Javelin” e që, sipas llogarisë të një supermashtguesi të LV-së, sasia e antitankëve është e mjaftueshme t’i shkatërrojë të gjitha tanket që i ka Serbia. Ky farë analisti i politikave të tredhura ka harruar se edhe gjatë bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, së paku 80 për qind e tankeve të shkatërruara serbe kanë qenë maketa. Po, në përgjithësi militantët e LV-së (militantë janë vetëm në marrje të posteve sepse me asgjë nuk janë Vetëvendosje) thuaja kanë filluar të formojnë njësi të gatshme të luftojnë me Serbinë... deri në ushtarin e fundit të KFOR-it. Disa që, me nder me thënë, janë anëtarë të shoqërisë civile, po thonë se tash janë të qetë sepse në vijën e parë të frontit janë KM i Kosovës, Albin Kurti, Xhelal Kaçketa, Dezhona Mihalidis, Hysamedin Ndryshku, Bojken Avazi dhe Elpis Hoxha. Pastaj, Mefistofeli me trup të madh dhe me zemër pule, pordhahedhësi Dimali dhe luftëtarët e fejsbukut me seli në Londër. Shumica e këtyre që i përmenda jo që nuk kanë luftuar kurrë, ndonëse përgjithësisht e kanë pasur moshën për të luftuar, por ose kanë ikur duke ofruar informacione për serbët kur janë zënë si “rob lufte”, ose i kanë hedhur armët rrugëve dhe maleve gjatë “tërheqjes strategjike”. Këta të shoqërisë civile që po u bien dauilleve të luftës, që më herët kanë siguruar strehimore në Beograd përmes platformës “Mirë dita - Dobar dan” dhe Grupit Nostalgjik për Rithemelimin e Jugosllavisë ku bëjnë pjesë bashkëmendimtarët e tyre nga Serbia, Bosnja, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e që si ind lidhës dhe interes të vetëm kanë projektet milionëshe të cilat i shëtitin nga xhirollogaria në xhirollogari pa i dhënë asnjë llogari askujt. Disave prej tyre vetëm iu mungon edhe një shajkaqë serbe me kokardën në të për ta kompletuar përmbytjen e tyre të brendshme “patriotike dhe kombëtare”. Këta jo që nuk do ta bëjnë kurrë luftën, por forcat serbe do t’i presin me lule, si çlirimtarë që realisht edhe i pranojnë si të tillë. Baballarët dhe majkat e tyre kanë qenë në shërbim të Jugosllavisë dhe të Serbisë,

prandaj edhe këta po e vazhdojnë traditën e paraardhësve politikë dhe biologjikë, asgjë më tepër. Ata që e bënë luftën, e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë e Kosovës dhe filluan ta ndërtojnë paqen sot janë në Hagë, këta që janë në pushtet po i gëzojnë të gjitha të mirat (si askush më parë) në sajë të pengjeve të Hagës, ish-të burgosurve politikë dhe ish-luftëtarëve të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës me dy komandantë, Baca Adem Demaçi, si komandant politik dhe Adem Jashari, si komandant ushtarak. Nëse mendoni se Vojsa Osmani, si komandante supreme e ushtrisë së Ukrainës, do të luftojë në Kosovë, do të thërrin sikur të flini në shtrat me kaktuse meksikane, nëse mendoni se Glok bin Sherifi do të luftojë, do të thërrin sikur të kaloni natën me dilberët e Peshevarit, kurse KM i Kosovës me kohë është deklaruar se është për luftë me shumë viktima, por pa pjesëmarrjen e tij sepse ka përcaktim paqësor që ia kalon edhe Rugovës. Në fund të fundit, Kuislingu nuk është nga Kosova. Është nga Norvegjia! Mjerimin e mjeranëve lehtësisht e identifikon si vetëlavdërim të atyre që nuk kanë të kaluar politike dhe kombëtare, e kanë një të tashme mashtroese nga e cila përfitojnë në të gjitha aspektet dhe nuk mund të kenë një të ardhme. Pra, ata jetojnë me mandat, sa zgjat mandati aq zgjasin edhe ata. Këtyre që u bien dauilleve të luftës, edhe nëse ua siguron armatimin e tërë botës, nuk iu duhet asgjë. Nuk kanë b..thë e as zemër ta përdorin. Janë pa rrënjë dhe i përkasin një trangu që na ka torturuar, arrestuar, dënuar, vrarë dhe zhbërë. Sa më shumë që flasin për luftë, më shumë do të bëjnë lëshime në dëm të Kosovës. Kur Besnik Muçiverca i pati vendosur të gjitha sanksionet e mundshme Ruisë, Putini i pati vendosur pesë stenta në prapanicë. Aq ishte trembur nga ky injorant mashtroes. Do ministresha që flasin për luftë këtë e bëjnë që të sigurojnë sa më shumë tenderë për burrat e tyre, asgjë më tepër. Prej se po flitet për Javelinët, Vuçiçi dhe Serbia gjumin gjumë nuk po e bëjnë, asgjë nuk po tremben nga Javelinët amerikanë sa nga pordhët dimalbashiane!

Wolkeri ante portas: Edhe për këtë përvjetor të masakrës së Reçakut, politikanët i ngjeshën radhët për të përfutur politikisht, pa qenë fare pjesë e asaj historie. Pa dashur të jenë pjesë e asaj historie, ndonëse kishin mundësi, por edhe detyrim njerëzor, politik dhe kombëtar. Tash, me eskorta të galanëve (xhipave), me truproja shumëfishë më të mëdha se “shkatërruesit e shtetit”, me mëditje të mira, i vizitojnë vendet ku ka lëshuar rrënjë kujtesa historike, kombëtare dhe politike e shqiptarëve në sajë të viktimave të shumta. E flasin ndonjë fjalim me patos patriotik të çastit, takojnë ndonjë nga të mbijetuarit

duke iu premtuar drejtësi për të cilën nuk kanë bërë asgjë. Sigurojnë drejtësi njëditore për të mbuluar padrejtësinë 364 ditore. Si vizitor i përherëshëm është William Wolker, ish-ambasadori i KDOM-it i cili doli në vend të ngjarjes, si ndërkombëtar i parë. Paraprakisht nga ai vend në KMDLNj pati raportuar Ruzhdi Jashari, aktivist i Këshillit dhe ushtar i UÇK-së. Wolkeri doli me një të vërtetë (sipas mandatit e kishte detyrim ta thoshte të vërtetën) që goditi fort pretendimet e rremë të Serbisë se viktimat janë ushtarë të UÇK-së që janë vrarë gjatë luftimeve. Wolkeri dëshmoi se të ekzekutuarit dhe të masakruarit ishin civilë të paarmatosur shqiptarë duke vënë në lëvizje mekanizma të fuqishëm ndërkombëtarë që parapriu edhe bombardimet e NATO-s. Wolkeri edhe këtë vit erdhi në Kosovë. Në Viti ia përuruan shtatoren sikur që e priten me gjithë respektin. Wolkeri në Reçak ka një status të veçantë që nuk e ka askush. Konsiderohet si zot i zotave! Wolkeri në kohën kur Albin Kurti shumicën e kohës e kalonte nëpër burgjet e Kosovës, pati bërë përpjekje ta zbusë, ta bëjë demokrat, ta bëjë Albinin që është sot. Për këtë e pati vizituar në burg, ndonëse nuk kishte të drejtë. Nuk ishte ndarë mirë në atë takim. Albinin nuk u zbut e as Wolkeri nuk përfitoi politikisht. Wolkeri u kthye në Amerikë, Albin u kthye në dhomën e burgut. Wolkeri pastaj u lidh me “shkatërruesit e shtetit” dhe nuk ishte në dashuri me Albinin. Kur Albinin u shndërrua në Cezar të Kosovës, Wolkeri iu ofrua duke e sulmuar Thaçin. Vitin e kaluar Wolkerit ia ndanë një 80-mijëshe. Këtë vit, përveç se ishte në Reçak, Wolkeri u takua me KM Kurtin për një ngjarje të natyrës personale, private, duke e njoftuar se pas dy javëve do të martohet. Sigurisht se i ka ftuar në dasmë KM Kurtin, Vojsa Osmanin presidente të Lutfi Hazirit, Glok bin Sherifin, frekuentues në lagjen e dajave të mi, te Bajçinocët (afër Lupçit të Epërm ku i kam dajat - Menxhiqë janë), Donika Katran Gërvallën dhe Zotërinë e Parë, Don Sadriazemin. Është ky gëzim kombëtar dhe shtetëror, prandaj nuk duhet të mungojnë, aq më parë që kohë më parë u përballën me një mërzi të madhe që iu shkaktoi vuajtje dhe dhimbje të papërballueshme - rrahja e Sandulloviqit nga BIA serbe. E çuditshme është jeta, edhe hidhërimi, edhe gëzime!

Liberalizimi i vizave dhe vetëlavdërimi i mizave: Më në fund u liberalizuan vizat. Kjo nuk do të ndodhte po të mos ishin KM i Kosovës, Albin Kurti, Vojsa Osmani, Glok bin Sherifi, Donika Katran Shvarci dhe referentët e Ministrisë së Drejtësisë. Menjëherë filluan lëvizjet drejt vendeve ku nuk kërkohet viza. Shumë shkuan në Greqi, në Gjermani, Zvicër, Norvegji (në gjini), Itali (Vali Corleone) dhe

në shtetet e tjera. Edhe unë lëviza, shkova në Prizren në takim me shokët e burgut, dikur edhe të idealit, bashkëmendimtarë dhe bashkëfajtorë për situatën e sotme. Ishin edhe shokët nga Maqedonia, Tahiri, Bejta dhe Asllan Luani. Natë e mrekullueshme ku evokoheshin kujtimet nga koha e kaluar në luftës. Disa ishim si Albini, nuk flisnim fare për luftë, e përshkruanim vetëm nga distanca e sigurt. Është mëkat që këta që kaluan tmerret e llogoreve dhe kampeve të ish-Jugosllavisë për to flasin vetëm në ndeja shokësh, këta të pushtetit të proveniencës jugosllave na konsiderojnë si të çmendur. Është e rëndë dhe e pafalshme që në emër të luftës sot flasin ata që e luftuan luftën, kurse ata që e bënë luftën flasin vetëm në ndeja shokësh sikur që ishte në ndejën në Prizren me rastin e pensionimit të Baralecit, ish-i burgosur politik dhe luftëtar i UÇK-së. Është e mrekullueshme që edhe sot Bacën Adem Demaçi e kemi frymëzim në ndeja shokësh, kujtime nga e kaluara, të sotëm sikur që edhe ardhmërinë e vulosim me Bacën. Ishim shokët e grupit “Baca Adem Demaçi”. Pata menduar të shkoj në Barcelonë shkaku i Mesit. Tash Mesi më nuk është, Barcelona po i ngjan politikës së jashtme të Kosovës, kujt po i çohet po ne e n..lë. Ani edhe klička e Realit na dha 4 gola. Po, për të shkuar në Barcelonë tash kam një motiv më të fuqishëm, më frymëzues, më motivues, më atraktiv; ta takoj Gani Jakupin, Ostap Benderin e Donika Katran Shvarcit. T’i përulem dhe t’i për(ç)kulem për të gjitha ato që i ka bërë për Takhikistanin. Pisa. Të poshtë. Mashtroes. Jam i painformuar krejtësisht. Vonë kuptova se Ganiu qenka me mision special atje, si agjent 069 dhe se mbi këtë shifër bashkëpunon ngushtë (shumë ngushtë) me agjentin tjetër po me këtë shifër 069 me emrin Elton Xhon. Tash jemi në rregull.

Të gjithë kundër Aliut, Aliu kundër askujt: Ali Ahmeti është udhëheqës i shqiptarëve në Maqedoni të Veriut. Ishte i burgosur në kampet e Jugosllavisë, ushtar i të gjitha luftërave çlirimtare që i bënë shqiptarët në ish-Jugosllavi. Gjatë kohës së udhëheqjes së tij politike shqiptarët e Maqedonisë dolën nga terri duke e parë dritën, dolën nga fundi i pusit për t’u bërë faktor i pashmangshëm për zhvillimet politike në Maqedoni, gjithnjë në mbrojtje të interesave të shqiptarëve. U identifikua me luftën çlirimtare të UÇK-së, UÇPMB-së dhe UKSh-së dhe asnjëherë nuk hoqi dorë nga lufta sikur që nuk hoqi dorë se BDI është parti e luftës. Gjatë bashkëpunimit me partitë maqedonase ishte veshur me gëzofin e dhelprës, ndërsa vendimarrjen e kishte të ujkut. Me shqiptarë ishte bashkëpunues, sidomos me Shqipërinë dhe Kosovën. Shqipërinë e konsideron si atdhe të të gjithë shqiptarëve, ndërsa

Kosovën si vendlindje politike dhe ushtarake ku u edukua për lirinë si vlerë kombëtare dhe universale. Të nevojshme dhe të domosdoshme jo vetëm për mbijetesë, por për një jetë më të mirë në mesin e popujve të mirë dhe të zhvilluar. Albin Kurti kohë më parë deshi t’ia fusë pykat në spicat e rotës drejt ardhmërisë së shqiptarëve në përgjithësi dhe atyre të Maqedonisë në veçanti. Nga BDI u nda një grup karrieristësh që veten e emërtuan me një emërtim biblik apo folklorik: “Grupi i Zjarrit”. Pikërisht këtë grup, bashkë me kundraxhiun e Erdoganit, Bilall (edhe djali i Erdoganit quhet Bilall) Kasamin, Albini deshi ta fuqizojë për detronizim të Ali Ahmetit në kohën kur për herë të parë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut do ta kenë (për 100 ditë) kryeministrin shqiptar, Talat Xhaferin, kryekuvendarin dhe ushtarin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Kur kjo punë u bë e madhe, Albini e dërgoi një rrogëtar për ta takuar Ali Ahmetin në përpjekje të fitojë kohë, deri në ndërhyrjen e radhës. Së fundmi doli me qëndrim se LV-ja do të jetë shtylla e katërt e opozitës shqiptare kundër shqiptarëve në Maqedoni, përkatësisht që Bilall Kasami, Afrim Gashi, Izet Mexhiti dhe Albin Kurti, bashkë me islamistët në këtë shtet, do të bëjnë përpjekje ta rrëzojnë Ali Ahmetin nga pushteti duke ia lënë trupin në Maqedoni, kurse kokën në Stamboll, si dikur Ali Pashë Tepelenës. Në Kinë, në kohën e Revolucionit Kulturor Kinez, ishte në fuqi “Banda e Katërshit” të njohur për krime monstruoze. Në Shqipëri e kemi “Katërshin e Albinit” që bëri përpjekje ta rrëzojë nga pushteti Edvin Ramën. Keq morën në thua dhe iu thyen dhëmbët. Nuk morën vota as sa për së gjalli. Ndjes pastë Haxhi Merxha, i fitonte në Kosovë! Pak dëgjoheshin përveçse kur duhej t’i arsyetonin pagat, lëshonin ndonjë pordhë ideologjike! Tash u ringjallën në luftën e Don Kishotit kundër Ali Ahmetit. E quajtën gjysh, babagjysh, katragjysh, pensionist etj. Në përpjekje që ta dëmtojnë. Edhe Lao Zënë e quajnë gjysh, plak të urtë, por se sa të jetë historia e njerëzimit ai do të mbetet një ndër shtyllat kryesore të kësaj historie. Nuk ka pushtet të përjetshëm, por ka kujtim dhe respekt të përjetshëm vetëm nëse keni lënë vepra të përjetshme për njerëzimin. Sigurisht se edhe Ali Ahmeti do të ikë nga kjo botë kur të jetë e shkruar. Mirëpo, në historinë e shqiptarëve kudo që jetojnë, ka zënë vend, prandaj këta xhonturqit e Albinit nuk mund ta zhvendosin në një histori tjetër. Grupi i Zjarrit e ka të pamundur ta djeg Ali Ahmetin me barot të lagur të Albin Kurtit. Lehtësisht mund të përsëritet historia me Edi Ramën. Në fund të fundit, Albin Kurtit më së paku që i duhet është përçarja e shqiptarëve në Maqedoni, se asgjë nuk fiton prej këtij diversioni. Mjaftueshëm i ka përçarë shqiptarët në Kosovë dhe në Luginë të Preshevës.

Haradinaj takon Cramonin: Heqja e sanksioneve nga BE-ja për Kosovën është e domosdoshme

Prishtinë, 15 janar - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim eurodeputeten gjermane, raportuesen për Kosovë, Viola von Cramon, të cilën e ka njoftuar për zhvillimet politike nëpër të cilat po kalon vendi ynë. “Shpreha vlerësimin tonë pozitiv për liberalizimin e vizave, ndërsa theksova nevojën që anëtarësimi në NATO dhe rrugëtimi i Kosovës drejt anëtarësimit të plotë në BE, është imperativ i kohës. Theksova se heqja e sanksioneve nga ana e BE-së për Kosovën është e domosdoshme për shkak të ndikimit negativ që kanë ato në jetën e qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Parandalohet kontrabandimi i 1 299 paketimeve me cigare

PRISHTINË, 15 JANAR - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, si rezultat i kryerjes së detyrave dhe autorizimeve zyrtare, kanë arritur ta identifikojnë dhe parandalojnë kryerjen e një rasti të kontrabandimit të mallrave nga tre persona të dyshuar të përfshirë në rast. “Me datë 14.01.2024 në fshatin Smirë komuna e Vitisë, policia kufitare ka identifikuar një automjet të dyshuar me targa vendore të cilën ishte duke e drejtuar i dyshuari mashkull kosovar, i cili njëherësh ishte duke përcjellë automjetin e dytë të dyshuar, të ngarkuar me mall të kontrabanduar, në të cilën ndodheshin edhe dy të dyshuarit tjerë meshkuj kosovarë. Pas përpjekjes së zyrtarëve policor për ta ndaluar veturën e dytë të dyshuar, e njëjta duke i rrezikuar seriozisht zyrtarët policorë dhe doganorë ka goditur veturën zyrtare. Zyrtarët policorë gjatë legjitimitetit të të dyshuarve, janë kanosur nga njëri prej tyre, dhe gjatë futjes në kontroll të një personi të dyshuar, një zyrtar policor ishte sulmuar, dhe ka pësuar lëndime trupore për të cilat i njëjti ka pranuar tretman mjekësor”, ka njoftuar policia. Në njoftim theksohet se gjatë kontrollit të automjetit të dyshuar, të ngarkuar me mallra të kontrabanduara, janë hasur sasi prej 1 299 paketimeve (boksa) të tri llojeve të ndryshme cigaresh, në sasi të përgjithshme rreth 260 000 cigare. Lidhur me rastin janë kontrolluar edhe shtëpitë e banimit të njërit nga të dyshuarit, por nuk është gjetur asgjë e dyshuar, ndërsa automjeti i dyshuar i lartcekur dhe malli i ngarkuar janë konfiskuar për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejme në terminalin doganor Dheu i Bardhë. Për të gjitha veprimet e ndërmarra nga Policia e Kosovës është njoftuar prokuroria kompetente dhe me urdhër të prokurorit përkatës dy persona të dyshuar janë ndaluar për 48 orë, ndërsa i dyshuari i tretë, identiteti i të cilit është i njohur për PK-në, ndodhet në kërkim policor.

Viola von Cramon thotë se qytetarët e Kosovës e kanë merituar liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 15 JANAR - Zëvendëskryeministri i parë për Integritim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur të hënën në takim raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, e cila shoqërohej nga shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. “Faleminderit për kontributin tuaj madhor dhe mbështetjen rreth arritjes së liberalizimit të vizave!”, u shpreh zëvendëskryeministri Bislimi në fillim të bisedës. Ndërsa Von Cramon, bashkë me urimin e saj, shtoi se qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë merituar këtë vendim dhe arritjen e liberalizimit të vizave. Në vijim u diskutua mbi angazhimin dhe përkushtimin e Kosovës drejt integritetit evropian, çështjet në lidhje me procesin e dialogut si dhe zhvillimet në vend, rajon dhe më gjerë. Në përfundim, zëvendëskryeministri Bislimi shprehu falënderimin dhe vlerësimin për rolin dhe angazhimin e Cramonit në Parlamentin Evropian dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës.

Fillon trajnimi i gjeneratës së re të Shërbimit Korrektues

PRISHTINË, 15 JANAR - Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ka filluar sot trajnimi profesional zyrtar korrektues i gjeneratës së 44-të të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Kjo gjeneratë ka gjithsej 70 kadetë. Menaxhmenti i lartë i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike i përshëndeti kadetët e rinj duke u uruar suksese në drejtimin që kanë zgjedhur. Kadetët do të trajnohen sipas planprogrameve të dizajnuara në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit.

Bizneset, të pakënaqura me ndryshimet ligjore për kontrata të punëtorëve



Prishtinë, 15 janar - Një numër i bizneseve në Kosovë ka shprehur pakënaqësi ndaj vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që punëtorëve t'u jepet kontratë qysh një ditë para fillimit të punës. Deri më tani bizneset kishin afat prej 45 ditësh pas fillimit të punës për ta regjistruar një punëtor.

Sipas pronarit të kompanisë “Eurofamis” nga Suhareka, Ilir Bytyçi, arsyeja pse ky ndryshim mund t'i dëmtojë bizneset vjen nga rreziku që punëtorët të vijnë në punë vetëm pak ditë dhe pastaj të largohen pa paralajmërim. Ai thotë se është përballur shpesh me raste të tilla dhe shton se nëse kontrata do të nënshkruhej qysh para fillimit të punës, atëherë kompanive do t'u shpëtonte barra administrative për përgatitjen e dokumenteve dhe ndërprerjen e kontratave. “Ne duhet të punësojmë punëtorë të tjerë në administratë që të merren me letra, ankesa... kjo ka kosto dhe është humbje kohe. Edhe ne si kompani kemi nevojë që punëtori disa ditë të punojë si punë provuese dhe më pas të nënshkruajmë kontratë. Duhet të bindemi edhe ne, edhe punëtori për kushtet e punës”, thotë Bytyçi për “Radion Evropa e Lirë”.

Kërkesa që kontrata mes punëdhënësit dhe punëtorit të nënshkruhet në ditën e parë të fillimit të punës bazohet në ndryshimet e Ligjit mbi Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 14 dhjetor. Në këtë ligj thuhet se “çdo punëdhënës duhet ta informojë Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për lidhjen e një kontrate të punës

një ditë para fillimit të punës së punëtorit”.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka paralajmëruar se do të ketë masa ndëshkuese ndaj bizneseve që nuk u përmbahen rregullave të reja. Në bazë të Ligjit të Punës, ndëshkimet mund të jenë nga 100 euro deri dhjetë mijë euro. “Në momentin që Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) shkon në kontroll dhe gjen punëtorë të padëkluar, patjetër do të ketë ndëshkim”, ka thënë ministri Murati.

Shkalla e punësimit në Kosovë në vitin 2022, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ka qenë 33.8 për qind apo mbi 403 mijë të punësuar. Sektori privat llogaritet punëdhënësi më i madh me rreth 300 mijë të punësuar. Ky sektor vazhdimisht ka pasur kritika për trajtim joadekuat të punëtorëve, madje në kundërshtim me Ligjin e Punës.

Që nga viti i kaluar ky sektor është duke u ballafaquar me mungesë të punëtorëve, disa janë në kërkim të kushteve më të favorshme dhe po lëvizin nga një kompani në tjetrën brenda Kosovës, ndërsa disa po kërkojnë punë në vende të BE-së.

Nënshkrimi i kontratës së punës nënkupton që punëdhënësi të detyrohet që të punësuarin ta paraqesë në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në institucionet e tjera, të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera. Të gjithë të punësuarit me kontratë në Kosovë paguajnë dhjetë për qind kontribute pensionale: pesë për qind paguhen nga punëdhënësi, kurse

pesë për qind ndahen nga paga e të punësuarit. Po ashtu, nga paga e punëtorit hiqet edhe vlera e Tatimit mbi të Ardhurat Personale, që sillet nga katër deri në dhjetë për qind, varësisht nga shumata e pagës.

Pronari i kompanisë “Frutex”, Shaqir Palushi, tashmë ka një vit që ka filluar me nënshkrimin e kontratave të punëtorëve që në ditën e parë të punës. Ai i frikësohet mundësisë së keqpërdorimit të kontratave nga punëtorët në rastet kur kompanitë nuk kanë mjaftueshëm staf ligjor e administrativ për t'i trajtuar problemet. “Deri më tash nuk na ka ndodhur, por ka mundësi që punëtori të punojë disa ditë dhe ta kërkojë pagën e plotë”, thekson ai.

Drejtori i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, Skënder Krasniqi, shprehet i shqetësuar që vendimi për ndryshimin ligjor për kontrata është bërë pa ndonjë konsultim me bizneset. “Problemet më të mëdha të bizneseve janë [gjetja e] kuadrove të diplomuara dhe [punësimi i personave] të pakualifikuar për pozitën e kërkuar. Dhe, në këto raste, nevojitet punë praktike njëmujore apo tremujore, që të shihet se a është punëtori i aftë për pozitën”, shprehet Krasniqi.

Synimi i qeverisë, formalizimi i punëtorëve

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se me këtë ndryshim nuk synohet të ndëshkohen bizneset, por synohet formalizimi i punëtorëve.


Deklarimi ose formalizimi i punëtorëve bëhet në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Zyra për informim e këtij institucioni thotë se problemi i mosdeklarimit të punëtorëve shfaqet vetëm në sektorin privat. “ATK-ja ka dy vjet që e ka hartuar projektin specifik për formalizimin e punësimit, nga i cili ka rezultate jo vetëm në numra, por edhe në sensibilizimin e punëtorëve për të kërkuar të drejtën e tyre”, thuhet në përgjigjen e ATK-së për REL-in. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2022 tregojnë se nga të punësuarit me kontratë në Kosovë, rreth 48 për qind kishin kontratë të përhershme, ndërsa rreth 52 për qind kontratë të përkohshme. Por, kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusf Azemi, thotë se në sektorin privat ka ende numër të madh të punëtorëve të paregjistruar. Megjithatë, ai beson se përderisa deri tash kompanitë kanë hezituar t'i regjistrojnë punëtorët, tashmë janë këta të fundit që nuk dëshirojnë të nënshkruajnë kontratë pa pasur kushte të favorshme të punës. “Për shkak se edhe brenda Kosovës ka lëvizje të punëtorëve nga një biznes në një tjetër, madje tash pas liberalizmit, edhe punëtorët që nuk dëshirojnë të largohen nga Kosova - dëshirojnë të kenë kontratë që i ofron siguri, pagë dhe respektim të orarit. Sot një pronar i një kompanie do të jetë shumë i gëzuar nëse arrin të nënshkruajë kontratë me punëtorin”, thotë ai. Për ta formalizuar tregun e punës dhe në përpjekje të rritjes së shkallës së punësimit, Qeveria e

Kosovës kishte lansuar platformën “Superpuna” në fillim të vitit të kaluar. Përmes kësaj platforme punëdhënësit mund të subvencionoheshin me nga 264 euro në muaj për ta mbuluar pagën e një punëtori. Punëdhënësi ka mundur t'i ofrojë punëtorit të tij pagë më të madhe se atë që shpesh shpesh shpesh vetë. E pas periudhës gjashtëmujore, atë që zgjaste subvencionimin, punëdhënësi mund ta mbante në punë punëtorin duke nënshkruar kontratë të re, por edhe mund ta shkarkonte. Përmes kësaj platforme janë punësuar mbi pesë mijë të rinj.

Praktikat e nënshkrimit të kontratave në vende të tjera

Në Shqipëri Kodi i Punës përcakton që në rastet kur “kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës ta hartojë me shkrim dokumentin përkatës të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit”. Por, në vendet më të zhvilluara perëndimore, praktikë mbetet që punëtorët të kenë kontratë qysh nga fillimi i punës. BE-ja rekomandon që punëtorët të marrin kontratë një ditë para fillimit të punës ose ditën e fillimit të punës. Megjithatë, edhe praktikat mes vendeve evropiane ndryshojnë. “Në disa vende të BE-së ju keni nga 1 javë deri në 2 muaj pas ditës së parë të punës për t'u dhënë punonjësve tuaj të rinj kushtet e punësimit”, thuhet në uebfaqen e BE-së.

Kush është Fito, Pablo Escobari i Ekuadorit që ka zhytur vendin në kaos



Ekuadori është në buzë të greminës, i pushtuar nga një spirale dhune që arriti kulmin, më 9 janar, në një ditë çmendurie me sulme të njëkohshme nga grupe të armatosura në qendra tregtare, zyra dhe madje edhe në një stacion televiziv gjatë një transmetimi të drejtpërdrejtë. Guayaquil, qyteti i dytë i vendit, përkon me epiqendrën e luftës midis forcave të policisë dhe komandove të lidhura me krimin e organizuar, të cilë autoritetet nuk kanë hezituar t'i përcaktojnë si “terroristë”. Lufta e brendshme ka rezultuar në një kaos të paprecedentë pas arratisjes të dielën e kaluar të Adolfo Macias, i njohur si “Fito”, kreut të bandës kriminale Los Choneros dhe shpërthimit të trazirave në gjashtë qendra dënimi në vend. Kush është ai dhe çfarë dimë për trafikantin e drogës që mban nën kontroll një popull të tërë?

Krimineli më i kërkuar i Ekuadorit

Adolfo Macías Villamar, i njohur më mirë si “Fito”, është lideri i Los Choneros, një bandë e fuqishme që besohet të jetë përgjegjëse për disa nga trazirat vdekjeprurëse të burgjeve në të gjithë

Ekuadorin në muajt e fundit. Ai u mbajt në zonën e sigurisë maksimale të burgut La Rajonal, në Guayaquil, një kompleks që ka gjithsej pesë burgje dhe më shumë se 12,000 të burgosur. Policia tha se ata e vunë re mungesën e tij herët në mëngjesin e së dielës dhe nuk ishin në gjendje ta gjenin.

Tani bosi i drogës është krimineli më i kërkuar në vend. I njëjti që me arratisjen e tij detyroi Presidentin Daniel Noboa të denonconte ekzistencën e një “konflikti të armatosur të brendshëm” në vend, duke urdhëruar Forcat e Armatosura të konsideronin grupet paraushtarake dhe bandat e lidhura me narkotikët si “objektiva ushtarake” dhe të dekretonte gjendjen e jashtëzakonshme për gjashtëdhjetë ditë.

Shumë pak dihen për Fiton. Gushtin e kaluar ai u transferua për një periudhë të shkurtër në La Roca, një burg më i vogël në të njëjtin kompleks, La Regional, i konsideruar më i sigurt për shkak të numrit më të vogël të të burgosurve. U deshën mijëra ushtarë për ta zhvendosur, por vetëm pas një muaji, avokati i të dënuarit paraqiti dhe fitoi ankesën kundër vendimit për transferimin e klientit të tij. Kështu Fito u rikthye në La Regional, vendi ku kaloi pjesën më të madhe të 12 viteve të tij të

fundit.

Në vitin 2013, ai dhe 17 të burgosur të tjerë u arratisën nga La Roca me varkë në lumin Daule, i cili kufizohet me kompleksin. I arratisuri u kap së bashku me vëllain e tij, anëtar i Los Choneros, katër muaj më vonë në shtëpinë e nënës së tyre në qytetin Manta.



Mes krimeve dhe burgut

Që atëherë, Fito, prejardhja modeste e të cilit ishte si shofer taksie dhe i klasifikuar nga qeveria si “kriminel me karakteristika jashtëzakonisht të rrezikshme”, i ka kaluar ditët në burg. Edhe pse burgosja e tij ka qenë gjithmonë shumë e rehatshme, e krahasueshme me atë të Pablo Escobarit në Kolumbi në vitet 1990. Në fakt, po qarkullojnë video që tregojnë festime brenda burgut me muzikantë dhe fishekzjarre, por edhe një narkokorridor për nder të tij në një oborr spanjoll, realizuar nga një mariachi dhe vajza e tij, e cila prezantohet si mbretëresha Michelle. Në regjistrim ai shfaqet duke përhëndetur, duke qeshur dhe duke përkëdhelur një gjel luftimi.

Ngritja e Fitos në krye të bandës, e përbërë nga rreth 8,000 njerëz, u bë e

mundur nga vdekjet, në një radhë të shpejtë, të paraardhësve të tij. Ai më vonë mori komandën e organizatës në vitin 2020, pas vrasjes së bashkëpunëtorëve Jorge Luis Zambrano dhe Junior Roldan. Madje Fito mori diplomën e drejtësisë në burg, ku vuante një dënim prej 34 vitesh për armëmbajtje, trafik droge, krim të organizuar dhe vrasje. Ngritja e tij në drejtimin e bandës u shoqërua me copëzimin e grupit, i cili deri në vdekjen e Zambranos kishte bashkuar shumicën e organizatave më të vogla.

Nga ana e tij, Fito akuzohet se ka nxitur vrasjen e kandidatit presidencial Fernando Villavicencio, i cili u qëllua për vdekje në gusht nga një vrasës kolumbian me pagesë. Fito nuk u dënua për atë krim, por qeveria e Presidentit të atëhershëm Guillermo Lasso (2021-2023) urdhëroi transferimin e tij në një burg të sigurisë maksimale, në një operacion spektakolar të zbatimit të ligjit që shkaktoi protesta nga të burgosurit. Por pas një farë kohe, falë një sërë teknikash ligjore, Fito u kthye në “çifligun” e tij, në burgun rajonal të Guayaquil. Para se të zhdukej pa lënë gjurmë. / il giornale – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Fofana, përforcimi i radhës i Drenicës

SKENDERAJ, 15 JANAR - Skuadra e Drenicës e ka realizuar edhe një transferim. Bëhet fjalë për sulmuesin Mohammed Fofana, i cili ishte pjesë e Prishtinës në Superligë. Klubi kuqezi që këtë edicion po bën gara në Ligën e Parë të Kosovës

ka paralajmëruar se deri në mbyllje të afatit kalimtar do të realizohen edhe tri transferime të tjera. “Qendërsulmuesi Mohammed Fofana është sulmuesi që përforcon skuadrën tonë. 23-vjeçari vjen nga FC Prishtina në formë

huazimi deri në përfundim të këtij edicioni. Fofana kishte disa paraqitje me FC Prishtinën në Superligë, kurse nga sot do të vishet ‘kuq e zi’. Ai sot është bashkuar me ekipin duke premtuar se do të japë maksimumin për ta ndihmuar

ekipin drejt arritjes së objektivave. Drejtuesit e klubit do të vazhdojnë të punojnë për përforcimin e ekipit dhe në vazhdim klubi do t’i transferojë edhe 2-3 futbollistë deri në mbylljen e afatit kalimtar”, thuhet në njoftimin e Drenicës.



Davisi, MVP i derbit dhe javës; Johnsoni, MVP në superligën e femrave

“Epoka e re”

Prishtinë, 15 janar - Java e 17 u karakterizua në shenjë të derbit në mes të Pejës dhe Trepçës që u fitua nga mitrovicasit. Te “Xehetarët” më i miri në parket ishte Kevin Davis, duke kontribuar me 20 pikë, shtatë kërcime, dy asistime, dy topa të vjedhur dhe një bllokadë. Davisi është një nga lojtarët më të dalluar të “Minatorëve” në këtë edicion. Ai u ndihmua nga Drilon Hajrizi, i cili e mbylli ndeshjen me 12 pikë, gjashtë kërcime, katër asistime, dy topa të vjedhur dhe dy bllokada, duke bërë një ndeshje shumë të mirë në triumfin në derbi. Bashkimi realizoi fitoren e dytë radhazi, duke mundur Istogun, ndërsa më i miri te prizrenasit ishte përforcimi Lejson Zeqiri me 24 pikë, 12 kërcime dhe dy



asistime, duke e pasur indeksin 34. Vëllaznimi shënoi fitore shumë të vlefshme ndaj Proton Cable Prizrenit, ku më i miri ishte Samuel Sessoms me 23 pikë, nëntë kërcime dhe nëntë asistime. Ai është ndër më të mirët te kuqezinjtë në këtë edicion. Edhe kjo fundjavë solli superndeshje në Superligën e Femrave. Vëmendja

kryesore ishte në Prizren, ku Prishtina arriti të triumfojë ndaj Bashkimit me rezultat 66:79. Për Prishtinën Asiana Johnson dhe Elektra Zyqaj ishin më meritoret për fitore në derbin e javës së 14-t. Johnsoni pati efikasitet prej 26 pikësh, 5 kërcime dhe 7 asistime, ndërsa Zyqaj shtoi edhe 22 pikë, 9 kërcime dhe 4 asistime. Ndeshje tjetër



interesante u zhvillua edhe në Mitrovicë, Penza arriti të fitojë ndaj Trepçës për herë të parë këtë edicion me rezultat të përgjithshëm 65:84. Saranda Daci me 25 pikë, 13 kërcime dhe 11 asistime si dhe Anita Grainca me 19 pikë e 9 kërcime ishin më meritoret për fitoren e Penzes. Fitore shënoi edhe Peja 03 në Gjilan ndaj United Basketball me rezultat 48:84,

më e dalluara te Peja 03 ishte Zërina Shatri me 12 pikë, 11 kërcime dhe 1 asistim.

MVP

Kevin Davis (Trepça) 20 pikë, 7 kërcime, 2 asistime, 26 indeksi

Top pesëshja

Kevin Davis (Trepça) 20 pikë, 7 kërcime, 2 asistime, 26 indeksi
Lejson Zeqiri (Bashkimi) 24 pikë, 12 kërcime, 2 asistime, 34 indeksi
Samuel Sessoms (Vëllaznimi) 23 pikë, 9 kërcime, 9 asistime, 29 indeksi
Drilon Hajrizi (Trepça) 12 pikë, 6 kërcime, 4 asistime, 19 indeksi
Shaheed Davis (Sigal Prishtina) 18 pikë, 8 kërcime, 0 asistime, 18 indeksi

Khaka dhe Zhegrova në formacionet e javës në Bundesliga dhe Liga 1

LEVERKUSEN, 15 JANAR - Dy futbollistët shqiptarë, Granit Khaka dhe Edon Zhegrova, kanë shkëlqyer në fundjavë me skuadrat e tyre, Bayer Leverkusen dhe Lille, si rezultat i kësaj janë në formacionet e javës në ligat përkatëse. Bayer Leverkuseni ka vazhduar me formë të shkëlqyer në Bundesliga, duke marrë fitore tek Augsburgu me rezultat minimal 0-1. Granit Khaka ishte ndër lojtarët më të mirë në këtë



sfidë, duke qenë i pakalueshëm në mesfushën e Leverkusenis. “Sofa Score” e ka futur mesfushorin shqiptar në formacionin më të

mirë të xhiros së 17 në elitën e futbollit gjerman Bundesliga. Përveç ylli të Kosovës, në këtë formacion janë edhe Trapp, Stark,

De Ligt, Gulde, Hofmann, Palacios, Grimaldo, Simons, Musiala, Hack. Ndërsa reprezentuesi i Kosovës, Edon Zhegrova, ka vazhduar me paraqitje fantastike në elitën e futbollit francez Liga 1 me fanellën e Lilles. Sulmuesi ka shënuar sërish gol këtë javë, kësaj radhe në fitoren bindëse të Lilles 3-0 ndaj Lorientit. Ishte minuta e fundit e ndeshjes kur Zhegrova depërtoi bukur nga krahuri i djathtë dhe me

një guajtje të fortë me të majtën realizoi për rezultatin përfundimtar 3-0. Ylli dardan kishte notë të lartë 8,4 dhe ishte ndër lojtarët me paraqitjen më të mirë në xhiron e 18 në Ligën 1. Sofascora e ka vendosur reprezentuesin e Kosovës në formacionin e javës në Ligën 1, ku në këtë formacion janë: Ndiay, Chardonnet, Marquinho, Gigot, Melou, Gomez, Zhegrova, Operi, Dembele, Mbappe, Barcola.

‘Medalja e Mirënjohjes’ për Getta Beqën, Veliaj: Krenar për vajzat dhe gratë shqiptare që kanë suksese në botë

TIRANË, 15 JANAR - Kampionia botërore në sportin e Bodybuildingut, Getta Beqa, u nderua me Medaljen “Mirënjohja e Qytetit” nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Në pritjen e organizuar për sportistën e njohur, Veliaj e falënderoi për suksesin e arritur dhe shtoi se është krenar për suksesin e të gjitha vajzave në sport. “Getta është ambasadorja më e mirë e të gjithë shqiptarëve në bodybuilding. Fakti se sot je jo

vetëm kampione e vendit, kampione e Ballkanit, por edhe kampione e Evropës dhe e Botës, tregon se vajzat tona mund të bëjnë gjëra të mrekullueshme. Ne jemi shumë krenarë për ty, edhe për modelin që përçon! Ka shumë sportistë të mirë që nuk janë doemos modele të mira. Ndaj, të jam vërtet mirënjohës, se na ke nderuar kaq shumë dhe në shenjë të kësaj mirënjohje, dua të ta dhuroj medaljen e Mirënjohjes që

u jepet personaliteteve që na kanë ngritur kokën lart. Mezi pres datën 29 janar, kur ne do ta kemi ceremoninë përmbyllëse të Tiranës si ‘Qyteti Evropian i Sportit’, titull që tani, këtë vit, do ta vazhdojnë Vlora dhe Prishtina, dhe me shpresë do të frymëzohen shumë qytete të tjera shqiptare, të inkurajojnë sportistët elitare, por edhe sportin në komunitet”, u shpreh Veliaj. Nga ana tjetër, Getta Beqa,

kampionia me origjinë shqiptare e Kampionatit Botëror të Bodybuildingut, falënderoi Bashkinë e Tiranës për gjithë mbështetjen që i jep sportit shqiptar. “Kryetari tha fjalë të cilat më emocionuan vërtet. Ishin fjalë që lartësuan edhe më shumë të gjitha sukseset që kam arritur. Shpresoj të jem model i të gjitha vajzave që mund të krijojnë familje, që mund të arrijnë gjithçka duan, mund t’i bëjnë të gjitha. Vetëm me kokën lart dhe duke



punuar shumë!”, u shpreh ajo. Getta Beqa ka shënuar sukses të madh në Kampionatin Botëror të Bodybuildingut që është mbajtur në Spanjë, duke u vlerësuar me medalje të artë.

Ancelotti: 11 trofe me Realin? Dua të luftoj për të 12-in

MADRID, 15 JANAR - Carlo Ancelotti, trajner i Realit të Madridit, e pranon se fitorja e thellë 4-1 në Superkupën e Spanjës ndaj Barcelonës ishte ndoshta paksa e tepruar, por skuadra e tij e meritoi dhe përfitoi nga pikat e dobëta të

rivalit historik. “Ishte një ndeshje e vështirë, nuk e prisja të shënonim kaq herët. Ne përfituam nga fakti që linja e tyre e mbrojtjes u vendos lart. Rezultati ishte i tepruar për mënyrën se si luajti Barcelona”, ka thënë Ancelotti.

Vinicius Jr. shkëlqeu me tre gola që në pjesën e parë. “Vini luajti shumë mirë. I duheshin dy ose tri ndeshje për t’u rikthyer në nivelin e tij më të mirë (braziliani ishte jashtë për një muaj për shkak të një problemi fizik). Skuadra është vërtet e mirë, ne jemi të motivuar,

veçanërisht pas fitimit të këtij trofeu. Për italianin ishte trofeu i 11-të si trajner i Realit, por ai e ka të qartë se cikli do ende kohë të mbyllet: “Jam i lumtur, por dua të luftoj për të 12-tin. A e kam kaluar rekordin e Zidanes? Ishte një natë e veçantë, por në Madrid



ka shumë net të tilla. Kjo është forca e këtij klubi”.

Verstappeni: Ja pse s’ka pilote femra në Formula 1

HASSELT, 15 JANAR - Kanë kaluar gati 50 vjet që nga hera e fundit që një femër merrte pjesë në një garë të Formulës 1. Hera e fundit ka ndodhur në vitin 1976, kur në Austri garonte Maria Grazia Lombardi. Asokohe disa pilote të tjera kanë provuar të garojnë në Formula 1, por pa mundur të kualifikoheshin. Sot rruga për në Formula 1 është edhe më e vështirë për një pilote femër, duke nisur nga karakteristikat teknike deri te paragjykimet. Për këtë arsye, për 30 vjet, nga 1992-shi, asnjë femër nuk zbret në pistë, madje as në provat e lira të ditës së premte. Ai që ka folur për këtë çështje është Max Verstappen, tri herë kampion bote me Red Bull. “Përqindja mes meshkujve dhe femrave në garat e makinave nuk është e drejtë. Për femrat është ende e vështirë, ndaj dhe janë më pak në garat e automobilizmit në të gjitha kategoritë”, ka thënë



holandezi. “Mendoj se fizikisht, në disa pista të Formulës 1 është më e vështirë të pilotosh, por me stërvitje dhe duke u impenjuar shumë, mund t’ia dalin mbanë. Gjithsesi, shefat e skuadrave të Formulës 1 mendojnë se duan vetëm meshkuj në skuadrat e tyre”, ka deklaruar Verstappen.

“Nëse do të ketë një femër do t’i mposhtë të tjerët, atëherë është natyrale që ajo të mbërrijë edhe në Formula 1. Për fat të keq, ka shumë pak femra që merren me këtë sport, ndaj shanset e atyre që të vijnë në majën e këtij sporti janë të pakta”, ka shtuar Verstappen.

Garë e fortë për kreun, Bucks fiton në shtesë, nuk fal Nuggets



MILWAUKEE, 15 JANAR - Skuadrat pretendente në NBA vijnë të dhurojnë spektakël në të dyja konferencat. Në Lindje, pas kohës shtesë, fiton Milwaukee, që mundi me rezultat 143-142 Sacramento, në një takim që dhuroi emocione deri në sekondat e fundit. Kjo ishte një ndër ndeshjet me më shumë pikë të këtij sezoni, me 285 pikë në

total. Për Bucksin, Antetokounmpo realizoi një “triple double”, me 27 pikë, 10 rebounde dhe 10 asistime, ndërsa Lillard i mbylli me 29 pikë. Në krahun tjetër, për Kingsin spikati Fox, autor i 32 pikëve, por që mbetën për statistikë. Në Perëndim fituan dy skuadrat e kreut. Minnesota mbron vendin e parë pas fitores 109-105 ndaj Los Angeles

Clippersit, sfidë ku Anthony Edwards realizoi 33 pikë për Wolvesin, duke i bërë të pavlefshme 50 pikët e dyshes Leonard-Powell për ekipin kalifornian. Kampionët e Denverit fituan 117-109 ndaj Indiana Pacersit, duke qëndruar në grupin e skuadrave që kryesojnë renditjen në Konferencën e Perëndimit. Takim i dominuar nga Nuggets, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë. Porteri, Jokiqi e Murray realizuan nga 25 pikë secili. Fiton edhe Phoenixi, që falë 34 pikëve të Bookerit, mundi 127-116 Portlandin, ndërsa Miami mposhti 104-87 Charlotten. Për nënkampionët u dallua Adebayo me 24 pikë.

REZULTATET	
Denver - Indiana	117-109
Miami - Charlotte	104-87
Milwaukee - Sacramento	143-142
Minnesota - Clippers	109-105
Portland - Phoenix	116-127

SHKURT

Xavi pas humbjes nga Real: E kam besimin e klubit

Trajneri Xavi Hernandez ka folur për humbjen e Barcelonës nga Real Madridi (4-1) në finalen e Superkupës së Spanjës. Trajneri i blaugranas ka thënë se ai nuk ndihet nën presion dhe ka besimin e bordit të klubit. “Kam besimin e klubit, kjo është mjaft e qartë. Unë besoj në projekt deri në fund. Ne duhet ta rivendosim veten dhe të luftojmë për tre trofetë e mbetur”, ka thënë Xavi. Nuk ka gjasa që Barcelona të marrë ndonjë vendim të madh për trajnerin e tyre pas humbjes në “El Clasico”. Më parë, Laporta deklaroi se do ta gjykojnë punën e tij vetëm në fund të sezonit.

Ten Hag: Sancho për t’u rikthyer në United duhet të kërkojë falje

Jadon Sancho pas një periudhe aspak të mirë në Manchester United u rikthye te Borussia Dortmundi në formë huazimi. Trajneri Erik Ten Hag ka thënë se sulmuesi anglez për t’u rikthyer në Manchester United duhet të kërkojë falje. “Për t’u rikthyer te ne do të duhet të kërkojë falje. Ai e di tashmë diçka të tillë, nuk ka kuptim të flas më për këtë. Koha e tij këtu sigurisht nuk ishte një sukses. Nuk ka asnjë tolerim për disiplinën në ekipin tim. Nuk e prisja atë nga një profesionist”, ka thënë Ten Hag.

Mourinhon rrezikon shkarkimin, Roma mendon për De Rossin

Humbja 3-1 ndaj Milanit, por edhe rezultatet dhe paraqitjet e fundit të Romës, mund t’i kushtojnë shtrenjtë Jose Mourinhos. Sipas asaj që raportohet nga “Sport Mediaset”, në fakt Friedkins mund të vendosë të ndryshojë trajner në ditët në vijim. Lista e kandidatëve për ta zënë vendin e “Special One” është e shkurtër. Sipas transmetuesit televiziv, ish-kapiteni i Romës, Daniele De Rossi, është mes kandidatëve potencialë. Bankina e parë dhe e fundit e ish-mesfushorit ishte ajo e SPAL-it, por falë të shkuarës së tij te verdhekuqtë, mund të ketë mbështetje të madhe nga tifozët e Romës.

Benzema mund t’i bashkohet Chelseat

Aventura e Karim Benzemasë në Arabinë Saudite duket se po i vjen fundi. Sipas “The Telegraph”, ish-sulmuesi i Realit të Madridit shihet si opsion për ta përforcuar sulmin e Chelseat. Fituesi i “Topit të Artë” dy vjet më parë nuk është paraqitur tek Al Ittihad dhe rasti i tij në Arabi duket se është shndërruar në një çështje shumë të mprehtë. Tani për tani Chelsea nuk mund të përballojë një operacion financiar aq të fuqishëm sa të shpenzojë më shumë se 100 milionë për Victor Osimhen, nga Napoli, dhe një tjetër prej objektivave të kësaj skuadre, Iván Toney, duket se do të vazhdojë te Brentfordi. Në këtë mënyrë, operacioni më logjik për Chelsean është gjetja e një sulmuesi në formë huazimi për pjesën e mbetur të sezonit që vjen nga Arabia Saudite. Janë dy emra që shfaqen në këtë skenar: Firmino dhe Benzema. Braziliani e njeh më mirë Premierë Ligën, por francezi ka mundësinë të kthehet në një futboll që e ka tërhequr gjithmonë dhe në të cilin nuk ka luajtur kurrë. Gjithçka do të varet nga vullneti i Chelseat, pasi duket qartë se Karim dëshiron të largohet nga futbolli saudit.

Van Dijk: Giroud është sulmuesi më i vështirë që jam përballur

Ylli i Liverpoolit, Virgil Van Dijk, i ka “injoruar” yjet e futbollit botëror si Lionel Messi, Cristiano Ronaldo dhe Erling Haaland, teksa ka përzgjedhur kundërshtarin e tij më të vështirë, që për shumëkënd mund të jetë një befasi.

Mbrojtësi holandez gjatë karrierës së tij ka pasur mundësinë të përballet me sulmues të klasës botërore. Në raste të ndryshme, ai ka pasur punë kundër emrave si Messi dhe Ronaldo dhe tani rregullisht përballet me Haalandin, pasi

norvegjezi iu bashkua Manchester Cityt në verën e vitit të kaluar. Por, Van Dijk e ka zgjedhur sulmuesin e Milanit, Olivier Giroud, si lojtarin që nuk i pëlqen ta ketë si kundërshtar. Reprezentuesi holandez ka luajtur ndaj Giroudit gjatë kohës

sa francezi ishte pjesë e Arsenalit dhe Chelseat, gjithashtu edhe në skenën ndërkombëtare ndaj Francës. “Mendoj se Olivier Giroud është sulmuesi më i vështirë që jam përballur. Në çdo ndeshje ju mendoj se e keni markuar atë mirë, por ai

g gjithmonë arrin të shënojë në një mënyrë ose tjetër. Me kokë, me këmbë, me gju. Ai shpeshherë ka shënuar ndaj meje (qesh)”, ka thënë Van Dijk. Përveç Giroud, Van Dijk ka përmendur edhe emra të tjerë si Agüero, Haaland dhe Jesus.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 15.01.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarin Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 31, Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, shpallë:

KONKURS ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

3 (Tre) bashkëpunëtor shkencor për sektorët kërkimorë shkencorë (zgjedhje - avancim), prej të cilëve:

- 1.1. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për tekste shkollore dhe mjete mësimore;
- 1.2. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për kurrikula dhe politika arsimore;
- 1.3. 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për zhvillim profesional të mësimdhënësve.

Përshkrimi i punëve për pozitën 1.1.

- Harton projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime në fushën e mjeteve dhe të teksteve mësimore;
- Bën hulumtime për përshtatshmërinë e mjeteve mësimore;
- Përpilon analiza dhe përgatit punime profesionale për fushën e teksteve shkollore dhe të mjeteve mësimore;
- Organizon debate profesionale lidhur me përshtatshmërisë e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e sektorit të hulumtimeve përkatëse;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore – shkencorë në sektorin përkatës;
- U ndihmon hulumtuesve në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore;
- Shkruan recensionet dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon shefi i sektorit dhe Drejtori.

Përshkrimi i punëve për pozitën 1.2.

- Harton projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse;
- Bën studime shkencore në fushën e kurrikulave të gjuhës shqipe dhe të komunikimit;
- Realizon studime shkencore në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Bën studime shkencore në fushën e mësimdhënies dhe të nxënies në lëndët gjuhësore dhe të letërsisë;
- Bën analiza për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të fushës së gjuhës shqipe e letërsisë, si dhe të gjuhëve;
- Bën studime në fushën e kurrikulave lëndore dhe përmbajtjeve mësimore të Gjuhës shqipe dhe letërsisë në arsimin special-inkluziv;
- Bën studime shkencore në lidhje me testimet ndërkombëtare në fushën e kulturës së leximit;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e sektorit të hulumtimeve përkatëse;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore – shkencorë në sektorin përkatës;
- U ndihmon hulumtuesve në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore;
- Shkruan recensionet dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon shefi i sektorit dhe Drejtori.

Përshkrimi i punëve për pozitën 1.3.

- Harton projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse;
- Studion probleme të ndryshme nga fusha e edukimit;
- Bën analiza, vlerësime, hulumtime në fushën e mësimdhënies dhe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Përpilon analiza dhe projekte hulumtuese në fushën e mësimdhënies dhe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Angazhohet për aftësimin profesional dhe avancim në karrierë;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e sektorit të hulumtimeve përkatëse;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore – shkencore në sektorin përkatës;
- U ndihmon hulumtuesve në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore;
- Shkruan recensionet dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon shefi i sektorit dhe Drejtori.

Kandidati për bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë shkallën e doktorit të shkencave;
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare. Punimet duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Të ketë të botuar monografi shkencore nga fusha përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime;
- CV-në, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Listën e botimeve në revista ndërkombëtare të njohura sipas rregulloreve në fuqi duke evidentuar: autori/ët, titulli i punimit, revista, numri dhe/apo vëllimi i botimit si dhe linku i indeksimit (me numër DOI);
- Listën e botimeve në revista tjera, vendore e ndërkombëtare duke evidentuar: autori/ët, titulli i botimit, lloji i botimit, botuesi dhe vëllimi i botimit (me <https://www...>);
- Dëshmi tjera për të arriturat shkencore (artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore etj.).

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, dhe Statutit të Institutit Pedagogjik.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga “Lorenç Antoni”, nr. 38).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Priština, 15.01.2024.

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02 maj 2013.), član 31, Statuta Pedagoškog instituta Kosova u Prištini, član 32, Zakona o radu br. 03/L212, raspisuje:

KONKURS
IZBOR, REIZBOR - NAPREDOVANJE NAUČNIH ZAPOSLENIH I
ISTRAŽIVAČA

3 (Tri) naučna saradnika za naučnoistraživačke sektore (izbor - napredovanje), od kojih:

- 1.4.1 (Jedan) naučni saradnik za udžbenike i nastavna sredstva;
- 1.5.1 (Jedan) naučni saradnik za kurikulume i obrazovne politike;
- 1.6.1 (Jedan) naučni saradnik za stručni razvoj nastavnika.

Opis posla za poziciju 1.1.

- Izrađuje istraživačko - naučne projekte iz odgovarajuće oblasti;
- Vršiti analize, procene i istraživanja u oblasti nastavnih sredstava i udžbenika;
- Vršiti istraživanja o prikladnosti nastavnih sredstava;
- Sastavlja analize i priprema stručne radove za oblast školskih udžbenika i nastavnih sredstava;
- Organizuje stručne debate u vezi sa podobnošću školskih udžbenika i nastavnih sredstava;
- Radi na samostalan način u naučnim istraživanjima odobrenim od odgovarajućeg organa, prema usvojenom planu;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga sektora odgovarajućih istraživanja;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata;
- Angažuje se u podizanju istraživačko-naučnih kapaciteta u odgovarajućem sektoru;
- Pomaže istraživačima u obavljanju njihovih zadataka;
- Izrađuje plan rada za godišnje aktivnosti;
- Piše recesije i procenu na zahtev Institucije;
- Priprema izveštaj o realizovanim radovima;
- Obavlja druge poslove koje mu delegira šef sektora i Direktor.

Opis poslova za poziciju 1.2.

- Izrađuje istraživačko - naučne projekte iz odgovarajuće oblasti;
- Vršiti naučne studije u oblasti kurikuluma albanskog jezika i komunikacije;
- Realizuje naučne studije na metodologiju nastave albanskog jezika i književnosti;
- Vršiti naučne studije u oblasti nastave i učenja iz predmeta jezika i književnosti;
- Vršiti analize za stručni razvoj nastavnika u oblasti albanskog jezika i književnosti, kao i jezika;
- Vršiti studije u oblasti predmetnih kurikuluma i nastavnih sadržaja Albanskog jezika i književnosti u specijalnom inkluzivnom obrazovanju;
- Vršiti naučne studije u vezi sa međunarodnim testovima u oblasti kulture čitanja;
- Radi na samostalan način u naučnim istraživanjima odobrenim od odgovarajućeg organa, prema usvojenom planu;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga sektora odgovarajućih istraživanja;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata;
- Angažuje se u podizanju istraživačko-naučnih kapaciteta u odgovarajućem sektoru;
- Pomaže istraživačima u obavljanju njihovih zadataka;
- Izrađuje plan rada za godišnje aktivnosti;
- Piše recesije i procenu na zahtev Institucije;
- Priprema izveštaj o realizovanim radovima;
- Obavlja druge poslove koje mu delegira šef sektora i Direktor.

Opis poslova za poziciju 1.3.

- Izrađuje istraživačko - naučne projekte iz odgovarajuće oblasti;
- Studira različite probleme iz oblasti vaspitanja;
- Vršiti analize, procene, istraživanja u oblasti nastave i stručnog razvoja nastavnika;
- Sastavlja analize i istraživačke projekte u oblasti nastave i stručnog razvoja nastavnika;
- Angažuje se za stručno osposobljavanje i napredovanje u karijeri;
- Radi na samostalan način u naučnim istraživanjima odobrenim od odgovarajućeg organa, prema usvojenom planu;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga sektora odgovarajućih istraživanja;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata;
- Angažuje se u podizanju istraživačko-naučnih kapaciteta u odgovarajućem sektoru;
- Pomaže istraživačima u obavljanju njihovih zadataka;
- Izrađuje plan rada za godišnje aktivnosti;
- Piše recesije i procenu na zahtev Institucije;
- Priprema izveštaj o realizovanim radovima;
- Obavlja druge poslove koje mu delegira šef sektora i Direktor.

Kandidat za naučnog saradnika mora da ispuni ove uslove:

- Da ima stepen doktora nauka;
- Da ima objavljen najmanje jedan (1) naučni rad u nekom relevantnom međunarodnom časopisu. Radovi moraju biti poznati prema propisima na snazi;
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, unutar i van zemlje, iz odgovarajuće oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo o naučnim i stručnim aktivnostima iz oblasti tražene konkursom;
- Da ima objavljene naučne monografije iz odgovarajuće oblasti.

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kandidatkinja mora dostaviti dokumentaciju kao u nastavku:

- Diplomu o završetku odgovarajućih studija (doktorat);
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokument izdat od nadležnog organa kojim se dokazuje da nisu pod istragom;
- CV, kojem se moraju priložiti potrebni dokazi za dokazivanje stanja prikazanog u njemu;
- Spisak publikacija u priznatim međunarodnim časopisima prema propisima na snazi, evidentirajući: autora/e, naslov rada, časopis, broj i/ili tom publikacije kao i link indeksiranja (sa DOI brojem);
- Spisak publikacija u drugim domaćim i međunarodnim časopisima, evidentirajući: autora/e, naslov publikacije, vrsta publikacije, izdavač i link publikacije (sa <https://www...>);
- Drugi dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige, monografije, naučne konferencije, itd.).

Izbor naučnog osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj delatnosti, i Statuta Pedagoškog instituta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Instituta na internetu.

Aplikaciji se prilažu kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koja zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Kandidati izabrani na uži spisak biće informisani pismeno ili telefonom u zakonskom roku od Instituta, i dužni su da sa sobom ponesu originalne dokumente o kvalifikacijama i završenim obukama za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na ovaj br. tel: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

Kompletirane aplikacije se dostavljaju na adresu: Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica “Lorenc Antoni”, br. 38).



Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/ L -212 të Punës të Republikës së Kosovës ,vendimit të Këshillit Drejtues të datës 24/07/2023 dhe nenit 5 të UA nr 7/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Oda e Farmacistëve shpall këtë:

Konkurs Publik

Nr references	01/2024
Emri i Institucioni	Oda e Farmacistëve të Kosovës
Titulli i punës:	Zyrtare për punën e organeve të OFK-së
Koeficienti i pagës	Me marrëveshje
Raporton te:	Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës:	Një vit me mundësi vazhdimi
Numri i ekzekutue	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat kryesore:

- Kryen punët administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OFK-së dhe organeve tjera;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarrëvajtje të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme dhe organeve tjera;
- Mirëmbanë dosjet e Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet të tjera të OFK-së si dhe palëve të treta
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.
- Ushtron edhe detyra tjera të përcaktuara nga mbikqyrësi i drejtpërdretë

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara për vendin e punës:

- të këtë kryer Fakultetin Ekonomik;
- 1 vite përvojë pune profesionale;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve (përparësi kandidatët me dëshmi përkatëse)
- Gatishmëri dhe aftësi për të bashkëpunuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira bashkëpunimi në harmoni ndërkolegiale
- Përvoja e punës është përparësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Aplikacioni mund të shkarkohet në ëeb faqen e OFK-së www.ofk-rks.net, mund të merret edhe në zyret e OFK-së apo me kërkesë në email adresen info@ofk-rks.net

Dorëzimi i aplikacioneve: Zyra administrative e OFK-së rr.Qamil Bala, Hyrja 8, Dera nr 34

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni në numër telefoni 048 572222, prej orës 09:00 – 14:30 ose email adresën info@ofk-rks.net

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbdhjetë)ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: 16/01/2024 deri më 31/01/2024,që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës dhe aplikacioni.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY -SUHAREKË

Datë: 15.01.2024

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-74243 të datës 27.11.2023 të Asamblesë Komunale, në bazë të vendimit të Asamblesë Komunale 01-Nr-016-74237 të datës 27.11.2023 për formimin e komisionit, në bazë të procesverbalit nr. 01/2024 të datës 15.01.2024, Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës , Rregullorja (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës , komisioni me datë 15.01.2024 shpallë:

ANKAND PUBLIK
Nr.01/2024

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë deri 15 (pesëmbdhjetë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Lokal afarist :- **O-72116046-56-1-1-0**, me sipërfaqe prej : **S=93.84m²**, në vendin e quajtur “**Fshat**” zona kadastrale Suharekë, rruga “Brigada 123” sipas certifikatës së pronës **nr.69463-2023** të datës 07.11.2023., në emër të Komunës së Suharekës , nga sipërfaqja e përgjithshme jepet për shfrytëzim **S=93.84m²** për ushtrimin e aktivitetit biznesor.

Dëshmitë e kërkuara:

- Kopja e dokumentit të identifikimit.
- Certifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
- Dëshmi për kryerjen e obligimeve, për personat juridik – Taksa Komunale.
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara.
- Çmimi fillestar për m² të lokalit – minimum 5euro(pese euro) /m².në muaj 60 pikëve
- Projekti ideor conceptual lidhur me zhvillimin e aktivitetit afaristo-biznesor vlersohet me 20 pikë.
- Numri I puntoreve vlerësohet me 20 pikë.

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria joadekuatë do të diskualifikohet nga ankandi.
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- Nga e drejta për pjesëmarrje në ankand, janë të përjashtuar të gjithë aplikantët të cilët kanë obligime të pa-shlyera ndaj Komunës

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **29.01.2024..**, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave deri më datë 30.01.2024 deri në ora 16 ,oferta duhet të jetë e protokoluar te zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me 01.02.2024 në ora 16:00 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfutjesin e vendos Kryetari I Komunës konform ligjit nr.04/L-144.

Informatat shtesë;
Nr. mob: 049563420
[@rks-gov.net](mailto:info@rks-gov.net)

Kryesuesi i komisionit:
Armend Krasniqi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sallon Ondulimi Teuta” SH.P.K. me seli në Vushtrri, me pronar Sanije Plakolli, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70180265 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Sallon Ondulimi Teuta” D.O.O. Vushtrri, sa vlasnikom Sanije Plakolli, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70180265 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Sallon Ondulimi Teuta” L.L.C. with headquarters Vushtrri, with owner Sanije Plakolli, has come to the decision to quit its business: 70180265 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Musa Grabanica shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik Prishtinë, me nr. 5366.

- Arbër Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10, 11, 12 dhe diplomën e sh.m. “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Alfred Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Ulvije Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m. “Mustafa Bakija” nga kl. I-IX.

- Rasim Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e A.P. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



100% Fresh & Natural

VIDAS Llatte drink 2%

VIDAS TAMËL 2,87

VIDAS Schmand 18% yndyrë 800g

VIDAS JOGURT 100% Fresh & Natural

VIDAS DHALLË

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

